Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e pranimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Blerina Huruglica	**13.10.2026**	**23.10.2026**	**2026/0777**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 09.10.2026, **OE "OFFICE 1 KOSOVA SH.P.K."- Prishtinë**, ka parashtruar ankesë me nr: **2026/0777**, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë **OE "Rexhep Biringjiku & Nita Macula B.I."** lidhur me aktivitetin e prokurimit: "**Furnizim me leter per kopje**" me nr. të prokurimit: "**201/26300-26-2073-1-1-1**", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues **(AK) – Agjencia Qendrore e Prokuimit .**

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: **Lot 2 – 690,000.00 €.**

Lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së, më **Nr. 2026/0486 i dt: 14.09.2026.**

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Neni 40 par. 40.9 dhe par. 40.10 lidhur me nenin 44 par. 3 të RRPP

Neni 41 par 3 lidhu me par. 10 të RRPP

Fillimisht duhet cekur se brenda afatit ligjor është parashtruar kërkesë për rishqyrtim pranë AK. Mirëpo në vendimin për refuzimin e kërkesës tonë për rishqyrtim, nuk janë shqyrtuar fare

pretendimet tona ankimore përmes të cilave kemi prezantuar argumente të matshme dhe të ligjshme që tenderuesi i rekomanduar ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme.

Sidoqoftë, ne kemi parashtruar këtë ankesë me shpresën që Paneli Shqyrtues do të trajtojë pretendimet tona seriozisht dhe të veprojë sipas legjislacionit në fuqi. Ne e kemi parasysh faktin që palët përgjegjëse në këtë aktivitet të prokurimit me veprimet e tyre kanë manifestuar edhe shkelje ligjore të natyrave tjera, ndërsa Paneli Shqyrtues në OSHP do të shqyrtojë ankesën vetëm në kuptim të organit epror të AK në kuadër të procedurës administrative lidhur me prokurimin publik. Mirëpo brenda afateve ligjore ne do të shfrytëzojmë të gjitha mjetet ligjore në dispozicion për të adresuar të gjitha shkeljet ligjore edhe pranë organeve tjera kompetente, me qëllim që në këtë aktivitet të prokurimit të mbrohet ligjshmëria dhe interesi publik.

Në vijim po përsërisim pretendimet ankimore identike sikurse në kërkesën për rishqyrtim:

Sipas vendimit të AK të dt. 24.09.2026 për Lot 2 është rekomanduar për kontratë GOE "Rexhep Birinxhiku & Nita Macula B.I.".

Fillimisht duhet sqaruar se kriteri i dhënies së kontratës ka qenë Oferta e Përgjegjshme me Çmimin më të lirë.

Në këtë aktivitet të prokurimit, oferta jonë si Office 1 Kosova Sh.P.K. është oferta e përgjegjshme me çmimin më të lirë të poentuar prej 533,384.00 euro. Ndërsa oferta e GOE që tani është rekomanduar për kontratë me çmim total prej 533,479.00 euro sipas procesverbalit të hapjes së ofertave është për 95 euro më e shtrenjtë sesa oferta jonë.

Vlen të shtohet fakti që në njoftimin për vendimin e AK të dt. 24.06.2026, AK e kishte rekomanduar ofertën tonë për kontratë duke e njohur si ofertën më të lirë të përgjegjshme.

Sidoqoftë, në njoftimin për vendimin e dytë të AK të dt. 24.09.2026 është rekomanduar për kontratë GOE "Rexhep Birinxhiku & Nita Macula B.I.". Në këtë vendim të AK është thënë se çmimi prej 533,479.00 i cili është evidentuar në formularin e tenderit si dhe në procesverbalin e hapjes, është "korrigjuar" në 527,620.00 euro.

Me këtë veprim janë manifestuar disa shkelje ligjore të cilat do të elaborohen detajisht në vijim.

Përndryshe, oferta e tenderuesit të rekomanduar edhe ashtu është e papërgjegjshme dhe duhet eliminuar në tërësi nga aktiviteti i prokurimit dhe jo të rekomandohet për kontratë.

Pretendimi nr. 1 - Korrigjimi është i kundërligjshëm me efekt nul (i pavlefshëm).

Përmes nenit 40.10 par. a) të RRPP përcaktohet se "Në rast se ka mospërputhje ndërmjet çmimit njësi dhe çmimit total që është fituar duke shumëzuar çmimin për njësi dhe sasisë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total do të korrigjohet". Në rastin konkret nuk ka mospërputhje në mes të çmimit njësi dhe çmimit total. Për të gjitha pozicionet në paramasë, nëse shumëzohet çmimi për njësi me sasinë e përcaktuar do të arrihet çmimet totale me të cilat ka ofertuar tenderuesi i rekomanduar.

Gjeni të bashkangjitur në aneksin e veçantë.

Numri i Prokurimit: 201/26300-26-2073-1-1-1- Titulli: Furnizim me letër për kopje

LISTA E ÇMIMEVE

FURNIZIM ME LETËR PËR KOPJE - LOT 2 - Furnizim me letër për kopje – Niveli Lokal

Nr.	Pershkrimi	Njesia	Sasia e përafërt	Cmimi per njesi me TVSH	Cmimi total me TVSH
1	**Letër univerzale për kopje A4/80 g/m2** - Sipas specifikave teknike të paraqitura në Aneksin 1.	rise	200,000	2.36	472,000.00
2	**Letër univerzale për kopje A4/100 g/m2** - Sipas specifikave teknike të paraqitura në Aneksin 1.	rise	12,000	2.47	29,640.00
3	**Letër univerzale për kopje A3/80 g/m2** - Sipas specifikave teknike të paraqitura në Aneksin 1.	rise	6,000	4.00	24,000.00
4	**Letër speciale për zyre A4/160 g/m2** - Sipas specifikave teknike të paraqitura në Aneksin 1.	rise	1,100	1.80	1,980.00

Sa i përket kuptimit të "çmimit për njësi" dhe "çmimit total" duhet ti referohemi vet paramasës së AK.

Kolona e fundit në të djathtë është çmimi total përkatësisht "çmimi total me TVSH", një kolonë para saj është çmimi për njësi përkatësisht "çmimi për njësi me TVSH" dhe para saj apo në mes të tabelës është edhe kolona e emërtuar si "sasia e përafërt".

Nëse e marrim si shembull pozicionin e parë, sasia është 200,000 ndërsa çmimi për njësi është 2.36 euro. Nëse shumëzohen këta 2 numra arrihet çmimi total i cili është 472,000.00 euro. Kjo nënkupton që te pozicioni i parë, çmimi për njësi dhe çmimi total përputhen saktë.

Ngjashëm vlen edhe për pozicionin e dytë ku sasi është 12,000 dhe çmimi njësi është 2.47 euro që nënkupton se çmimi total është 29,640.00 euro dhe përputhen saktë me kalkulimet e bëra nga tenderuesi i rekomanduar. Ngjashëm vlen edhe për pozicionin 3 (6,000 njësi x 4.0 euro = 24,000 euro çmimi total) si dhe për pozicionin 4 (1,100 njësi x 1.80 euro = 1,980.00 euro çmimi total).

Pra në kuptim të nenit 40.10 par. a) të RRPP, nuk ekziston asnjë gabim aritmetikor me rastin e kalkulimit të çmimit njësi dhe çmimeve totale me të cilat ka ofertuar tenderuesi i rekomanduar. Rrjedhimisht nuk ka as bazë ligjor apo arsye për ndonjë korrigjim eventual.

Paradoksi qëndron te fakti që këtë shpjegim e ka dhënë vet AK me rastin e njoftimit për vendimin e parë përkatësisht me rastin e vendimit të dt. 06.07.2026 për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim kundër atij vendimi të parashtruar nga tenderuesi që tani është rekomanduar për kontratë. Në fakt, AK kishte shkuar edhe një hap më tutje, duke konfirmuar jo vetëm që nuk ka bazë ligjore për korrigjim por duke sqaruar që në rast të korrigjimit eventual kjo do të përbënte shkelje të drejtpërdrejtë të konkurrencës në mes të OE përmes diskriminimit apo

favorizimit në kuptim të nenit 7 të LPP.

Sidoqoftë, në njoftimin mbi vendimin e AK të dt. 24.09.2026 thuhet se çmimi i ofertuar nga tenderuesi i rekomanduar është "korrigjuar" nga 533,479.00 euro në 527,620.00 euro. Nëse marrim parasysh argumentet e prezantuara më sipër, mund të shihet se në këtë rast nuk kemi të bëjmë me korrigjim të çmimit por me ulje (zbritje) të çmimit final me të cilin ka ofertuar tenderuesi i rekomanduar. Pra aktualisht jemi në një pozicion ku tenderuesi i rekomanduar ka prezantuar një tjetër çmim në formularin e tenderit i cili është lexuar edhe me rastin e hapjes së ofertave, mirëpo me krejt tjetër çmim tani po shpallet fitues dhe po rekomandohet për dhënien e kontratës.

Për fat të mirë, edhe kjo çështje është parashikuar dhe është zgjidhur në mënyrë të drejtë nga rregullorja në fuqi e prokurimit publik. Konkretisht, përmes nenit 40.10 par. b) përcaktohet se "Në rast se ka mospërputhje mes çmimit total në Formularin e Tenderit dhe totalit në Përshkrim të çmimeve, oferta refuzohet". Në rastin konkret çmimi në formularin e tenderit dhe në procesverbalin e hapjes së ofertave është 533,479.00 euro mirëpo në njoftimin mbi vendimin e AK thuhet se çmimi i tenderuesit është 527,620.00 euro. Pra kemi një mospërputhje të hapur në mes të çmimeve të prezantuara nga OE. Në këto raste, duke u bazuar në nenin 40.10 par. b), AK nuk duhet të rekomandoj për kontratë OE por duhet të refuzoj ofertën duke e eliminuar si të papërgjegjshëm nga aktiviteti i prokurimit.

Vlen të shtohet fakti që paramasa e publikuar nga AK në platformën eprokurimi, ka qenë në formatin excel e cila e ka pasur të integruar edhe formulën për llogaritjen automatike të çmimit total (nga sasia dhe çmimi për njësi) por edhe të çmimit final për ofertim. Pra fakti nëse çmimi final është i saktë apo jo, fillimisht është përgjegjësi ekskluzive e vet OE. Mbi të gjitha, nëse OE ka ndërhyrë në tabelat excel të paramasës së prezantuar nga AK, atëherë kjo përbën ndërhyrje të formularët për ofertim të prezantuar nga AK. Sipas pikës 10 të UPP, nëse një OE ndërhyn në formularët e shkresave automatikisht duhet ti refuzohet oferta si e papërgjegjshme pa të drejtën për të kërkuar sqarime shtesë.

Në fund, nëse AK paska drejtë të ulët çmimet me të cilat ka ofertuar një OE i caktuar (edhe pse nuk ka gabime aritmetike në mes të çmimit total përkatësisht sasisë dhe çmimit njësi), atëherë kërkojmë që AK të ulë edhe çmimin final me të cilin ne kemi ofertuar dhe atë për saktësisht 1 euro më pak se çmimi i tenderuesit të rekomanduar. Si arsyetim le të përdoret edhe te rasti ynë "korrigjimi". Natyrisht që kjo kërkesë është retorike sepse një veprim i tillë nuk ka as bazë ligjore dhe as logjike. Prandaj edhe oferta e tenderuesit të rekomanduar duhet të eliminohet si e papërgjegjshme dhe jo të rekomandohet për kontratë.

Kjo sepse oferta e vetme që ka përmbushur kriterin e dhënies është oferta nga Office 1 Kosova.

Pretendimi nr. 2 - AK nuk ka publikuar formularin B49 dhe nuk ka njoftuar OE

Përmes nenit 40.9 par. a) të RRPP përcaktohet se "AK do të përmirësoj gabimet e tilla dhe do të informoj me shkrim OE në fjale duke përdorur formën standarde B49. ... AK gjithashtu duhet ti dërgojë të gjithë tenderuesve përkatës (OE të cilët kanë dorëzuar tender) një njoftim me shkrim mbi ndryshimet e tilla".

Në rastin konkret AK asnjëherë nuk ka publikuar formularin B49. Përndryshe as ne si OE nuk kemi pranuar ndonjë njoftim me shkrim për këtë çështje. Pra në mënyrë flagrante është shkelur

edhe dispozita e nenit 40.9 par. a) të RRPP.

Pra nuk kemi të bëjmë vetëm me aplikimin e gabuar të së drejtës materiale (duke qenë se AK ska pasur fare të drejtë që në emër të korrigjimit të zbresë çmimin final me të cilin ka ofertuar OE i rekomanduar), mirëpo edhe dispozitat procedurale të korrigjimit si të tilla nuk janë zbatuar fare nga AK.

Pretendimi nr. 3 - Korrigjimi nuk është bërë gjatë vlerësimit nga komisioni vlerësues

Përmes nenit 40.9 të RRPP përcaktohet si vijon: "Komisioni vlerësues do të përmirësojë gabimet plotësisht aritmetike në tender nëse gabimet e tilla zbulohen gjatë ekzaminimit të tenderëve". Nga këndvështrimi i kësaj dispozite, duhet sqaruar që komisioni vlerësues as me rastin e vlerësimit të parë dhe as me rastin e rivlerësimit nuk ka zbuluar asnjë gabim aritmetik (pasi që çmimet totale janë kalkuluar saktë duke shumëzuar sasinë dhe çmimet për njësi). Ky fakt mund të konfirmohet nëse shohim raportet e vlerësimit të komisioneve. As në raportin e vlerësimit të parë dhe as në raportin e rivlerësimit nuk flitet askund për gabime aritmetike. Në fakt, te raporti i rivlerësimit në faqe 13 te pjesa e deklarimeve për të gjeturat thuhet se "Komisioni i vlerësimit duke vepruar në përputhje me Vendimin e OSHP-së nr. 2026/0468, e ka rivlerësuar ofertën dhe ka konstatuar se oferta është e përgjegjshme". Pra komisioni vlerësues askund nuk konstaton se është bindur për njërin fakt ose tjetrin, por vetëm thirret në vendimin e OSHP.

Përndryshe edhe vendimi i OSHP ka pasaktësi të caktuara si p.sh. në faqe 13 ku thuhet se AK nuk ka dërguar përgjigje ndaj raportit të ekspertes shqyrtuese. Në ndërkohë ne përmes qasjes në dokumente kemi pranuar nga AK me të cilën është kundërshtuar në tërësi raporti i ekspertes. Kjo përbënë ndër të tjera vërtetim të plotë të gjendjes Gjeni të bashkangjitur në aneksin e veçantë. faktike që është shkelje ligjore në vete.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government
Ministria e Financave - Ministarstvo za Finansije - Ministry of Finance
AGJENCIA QENDRORE E PROKURIMIT
CENTRALNA AGENCIA NABAVKE / CENTRAL PROCUREMENT AGENCY

Përgjigja e raportuar

Aktiviteti i prokurimit: "Furnizim me leter per kopje" LOT 2 me nr. të prokurimit: "201/26300-26-2073-1-1-1

Ekspertja shqyrtuese në përgjigjen e saj ne paragrafin e parë sqaron qartë situatën duke konfirmuar që AK ka ngarkuar përshkrim të çmimit me formula të gatshme me ç'rast pamundësohet gabimi aritmetik i paqëllimshëm.

Por pastaj në paragrafin e dytë tenton ta arsyetoj veprimin e OE-së duke tentuar ta largoje atë nga përgjegjësia e tentimit të manipulimit të konkurrencës.

Por ja sqarimi pse nuk qëndron ajo që cek ekspertja. - Nëse OE do te ofronte me "gabim të qëllimshëm" çmim me të ulët se çmimi real atëherë AK do të duhej me korrigjim t'i rriste ofertën dhe me atë rast do ti humbiste mundësia të tërhiqej nga procedura pasi që nuk do të mund të refuzonte një korrigjim që i rrit ofertën, për këtë arsye tentohet te ofrohet çmimi me gabim aritmetik më i lartë se çmimi real që pastaj nëse do ti duhej të tërhiqej të mos e pranonte korrigjimi i cili do ti ulte ofertën.

AQP nuk pajtohet me eksperten në rekomandimin e saj dhe njofton panelin shqyrtues që veprimi i AK-AQP është vetëm për të siguruar një konkurrencë të drejt dhe të largoj këto lloj tentime të keqpërdorimit të ligjit dhe rregullores. Gjithsesi AK-AQP do të respektoj dhe do të veprojë sipas vendimit të panelit shqyrtues.

Tani sa i përket vendimit të OSHP, Paneli Shqyrtues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertes shqyrtuese. Ndërsa në raportin e ekspertes shqyrtuese prezantohet një argument i vetëm ku thuhet që OE nuk ka pasur qëllim të manipulimit sepse po të kishte pasur qëllime për manipulim nuk do të kishte ofertuar me çmim më të shtrenjtë por më të ulët. Fillimisht nuk është në mandatin e ekspertes për të vlerësuar qëllime apo mendimet e askujt por vetëm dispozitat ligjore dhe argumentet/provat e rastit. Tutje, po të mos kishim dorëzuar edhe ne ofertë në këtë aktivitet, AK paska pasur për të shpallur si fitues tenderuesin e rekomanduar me çmimin që ka ofertuar duke qenë se gjatë vlerësimit komisioni nuk ka gjetur asnjë gabim aritmetik.

Pyetja retorike që shtrohet në këtë rast është se me cilin çmim kishte për tu shpallur fitues tenderuesi i rekomanduar, nëse ne nuk do të kishim ofertuar me çmim më të lirë sesa ata?! Natyrisht që kontrata do të lidhej me çmimin që është shënuar në formularin e tenderit i cili është lexuar edhe në procesverbalin për hapjen e ofertave.

Ndërsa sa i përket qëllimit manipulativ të tenderuesit të rekomanduar, duhet të ceket tenderuesi i rekomanduar për këtë kontratë "Nita Macula" ka lidhje familjare edhe me dy OE tjerë që kanë ofertuar në këtë aktivitet. Konkretisht, e njëjta është bashkëshortja e z. Blend

Rama përfaqësuesit të OE "NTG Blendi OP". Ndërsa bashkëshorti Blend Rama është vëllau i z. Bleron Rama (kunati i Nita Maculës) i cili është përfaqësues - bashkëpronar i OE "Grafo Loni". Pra personat kryesor në të tri kompanitë kanë lidhje të ngushtë familjare mes tyre. Në fakt edhe në Informatat e Bizneseve, adresa e tyre e banimit deklaruar në ARBK është e njëjtë te rr. "Gustav Majer" nr. 13 në Prishtinë, ku është edhe selia e biznesit OE "NTG Blendi OP".

Nëse marrim parasysh këto fakte (dhe disa prova të tjera të cilat nuk janë për këtë fazë), mund të konfirmohet që të tri kompanitë kanë pasur marrëveshje mes tyre me qëllim të kufizimit apo shtrembërimit të konkurrencës në këtë aktivitet, duke koordinuar çmimet e ofertuara, kufizimin e tregut, dhe koordinimin e ofertave të dorëzuara në përgjithësi.

Përmes nenit 5 par. 1 të ligjit nr. 08/L-056 për mbrojtjen e konkurrencës përcakton si në vijim "Ndalohen të gjitha marrëveshjet që kanë për qëllim parandalimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës në tregun përkatës".

Duhet theksuar faktin që lotin 1 të këtij aktiviteti e ka fituar OE "NTG Blendi OP". Tani për lotin 2 është rekomanduar "Nita Macula BI". **Pra lotin 1 e ka fituar bashkëshorti ndërsa lotin 2 bashkëshortja.** Që të dy lotet i ka fituar një familje! Ky fakt përbën shkeljen më flagrante të mundshme për kufizimin e konkurrencës së tregut dhe shkeljen e dispozitës së lartëcekur nga ligji për mbrojtjen e konkurrencës të cituar më sipër.

Përtej këtij fakti, në fund duhet sqaruar që vendimi i OSHP askund nuk e ka detyruar AK për të zbritur çmimin e ofertuar nga OE në mënyrë të kundërligjshme. OSHP në vendimin e saj thjeshtë ka kthyer në rivlerësim aktivitetin dhe ka udhëzuar AK që të verifikoj nëse ka gabime aritmetike në mes të çmimit total me tvsh i cili arrihet kur shumëzohet çmimi për njësi me sasinë e parashikuar. Nëse nuk ka gabime të tilla, ska nevojë as për korrigjim.

OSHP nuk ka thënë që të zvogëlojë çmimet e ofertave për ti mundësuar një OE të caktuar që kundërligjshëm të shpallet fitues në këtë aktivitet.

Pretendimi nr. 4 - Tenderuesi i rekomanduar ka ofertuar me çmim jonormalisht të ulët

Përmes nenit 41 par. 3 të RRPP përcaktohet si në vijim:

"Autoritetet kontraktuese do të kërkojnë nga operatorët ekonomik për të shpjeguar çmimin e ofruar për tenderët e përgjegjshëm, kur të përmbushen të gjitha kushtet e mëposhtme:

i. çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm;

ii. çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët;

iii. janë dorëzuar të paktën 3 (tre) tenderë.

Tenderuesi i rekomanduar për pozicionin 4 të paramasës ka ofertuar me çmim për njësi prej 1.80 euro.

Shihni figurat në aneksin e veçantë.

4	Letër speciale për zyre A4/160 g/m2 - Sipas specifikave teknike të paraqitura në Aneksin 1.	rise	1,100	1.80	1,980.00

Për pozicionin nr. 4, OE tjerë kanë ofertuar me çmimet si vijon:

CMIMET E OFERTUARA NGA OE PËR POZICIONIN NR. 4 TË PARAMASËS	
Operatori Ekonomik	***Çmimi për njësi të ofertuara***
1. GOE "Rexhep Birinxhiku & Nita Macula"	1.80 euro
2. "NTG Blendi OP"	2.10 euro
3. "G.I. Grafo Loni shpk"	2.25 euro
4. "Office 1 Kosova shpk"	2.64 euro
5. "Letra Com shpk"	2.75 euro
6. "Infosoft office shpk"	5.14 euro

Mesatarja e çmimeve për njësi të ofertuara nga OE për pozicionin 4 është 2.78 euro.

Kjo nënkupton çmimi i ofertuar nga tenderuesi i rekomanduar prej 1.80 euro është 35.26% më i lirë (pra mbi 30%) edhe se mesatarja e të gjitha çmimeve të ofertuara. Njëkohësisht çmimi për njësi i ofertuar nga tenderuesi i rekomanduar me 1.80 euro është 14.3% më i ulët (pra më shumë se 10%) sesa çmimi i dytë më i lirë që në këtë rast është çmimi i bashkëshortit të saj Blendi OP me 2.10 euro.

Kësisoj ky çmim për njësi me të cilin ka ofertuar tenderuesi i rekomanduar për poz. 4 të paramsës, është çmim jonormalisht i ulët në kuptim të nenit 41 par. 3 të RRPP. Pra nëse AK do të lidhë kontratë me tenderuesin e rekomanduar, kjo e fundit nuk do të ketë mundësi fare që të realizoj furnizimet për këtë pozicion duke bërë që të dështoj në tërësi kontrata dhe të dëmtohet buxheti i AK, sepse çmimi i ofertuar nga tenderuesi është çmim manipulativ.

Vetëm Office 1 Kosova shpk ka dorëzuar ofertë të përgjegjshme me çmime të vërteta sipas tregut. Kjo për arsye se ne jemi nga importuesit më të mëdhenj të letrës për Republikën e Kosovës. Fillimisht duhet sqaruar që Kosova nuk është prodhuese e letrës. Kjo nënkupton që për të furnizuar AK me letër, OE duhet të importoj letrën nga prodhues i letrës në shtetet tjera. Për të shpjeguar ekonominë e procesit të importimit të letrës nga importimi deri te furnizimi, shkurtimisht po prezantojmë elaboratin e çmimit në aneksin e veçantë.



"OFFICE 1 KOSOVA" SH.P.K.

NJOFTIM

për çmimin e letrës A4/160gsm

Përshkrimi	Për ton	Për 24 tonë
Blerja e letrës	500.00 €	12,000.00 €
Transporti: 3.000 € ÷ 24 tonë	125.00 €	3,000.00 €
Konvertimi dhe paketimi	150.00 €	3,600.00 €
Totali pa TVSH	**775.00 €**	**18,600.00 €**
TVSH 18%	139.50 €	3,348.00 €
Totali me TVSH	**914.50 €**	**21,948.00 €**

Marrë parasysh se pesha e një risi letër është **2,4948 kg**, nga 24 tonë dalin rreth **9620 risa**, pa humbjet gjatë konvertimit dhe paketimit.

Totali me TVSH është **21,948.00 €**, kur e përpjestojmë për **9620 risa**, çmimi del **2,28€/ris me TVSH**.

Duke llogaritur edhe **3%** humbje gjatë konvertimit dhe paketimit, kostoja përfundimtare bëhet **2,35€/ris me TVSH**.

"Office 1 Kosova"

Pra çmimi më i lirë i mundshëm me të cilin mund të shitet ky produkt sot në tregun e Kosovës (pa kalkuluar fitimin për OE dhe pa kalkuluar humbjet gjatë konvertimit dhe paketimit) është 2.28 euro. Për të pasur sado pak fitim, duhet të shitet me 2.64 sikurse kemi ofertuar ne. Për të argumentuar kalkulimin e prezantuar më sipër, po ju prezantojmë në aneksin e veçantë edhe një faturë nga njëri prej prodhuesve të letrës.

HSH Papier

HSH Papier GmbH & Co. KG • Chrysanderstr. 2b • D- 21029 Hamburg

Firma
Office1 Kosova SHPK
Tirana n.n

20000 Prizren
Kosovo

Customer No.:	72174
Order No.:	384/250912
VAT-Id:	DE306648830
Date:	02.05.2026

Pro forma Invoice No. 160

FCA 25348 Glückstadt

Qty.Unit	Description	Unit price EUR	Value EUR
23.952 t	Paper 160gsm, A1 (594x841mm) 48 pallets x 499 kg = 23.952 kg	500,00	11.976,00
Net amount			11.976,00
tax free		11.976,00	
Gesamtbetrag			**11.976,00**

Vorkasse

Payment term in your bank: OUR

Steuerfreie Ausfuhrlieferung § 4 Nr. 1 Buchst. a iVm. § 6 UStG/
a tax-free export delivery

Es gelten die AGB der HSH Papier GmbH & Co. KG, die wir Ihnen auf Anfrage gern zusenden.
The terms and conditions of HSH Papier GmbH & Co. KG apply, which we will be happy to send you on request.

Për këto arsye, AK duhet të eliminoj ofertën e tenderuesit të rekomanduar si të papërgjegjshme për shkak se ka ofertuar me çmime manipulative dhe jonormalisht të ulëta në kuptim të nenit 41 të RRPP.

Nga sa u tha më sipër, propozojmë që të merret ky:

VENDIM

MIRATOHET si e bazuar ankesa ashtu që anulohet njoftimi mbi vendimin e AK ndërsa aktiviteti i prokurimit kthehet në rivlerësim.

KRITERET PËR VLERËSIM

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

///

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

///

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

//

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

///

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **OFFICE 1 KOSOVA SH.P.K.**

Aktiviteti i prokurimit me titull: "**Furnizim me leter per kopje**" **LOT 2** me nr. të prokurimit: "**201/26300-26-2073-1-1-1**", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues **(AK) – Agjencia Qendrore e Prokruimit,** me procedurë të hapur, kontratë publike kornizë- furnizim, kriteri çmimi më i ulët i përgjegjshëm.

Ankesa është e parashtruar **për LOT 2.**

Lidhur me këtë aktivitet të prokurimit gjendet vendimi i **Panelit Shqyrtues me nr. 0486/2026 data: 14/09/2026,** sipas të cilit vendim lënda LOT 2 është kthyer në Rivlerësim.

Citat PSH 0486/2026:

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me leter per kopje" LOT 2 me nr. të prokurimit: "201/26300-26-2073-1-1-1"

Paneli Shqyrtues, administroi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë aktet dhe veprimet e AK, parashtresat dhe provat e ankuesit dhe raportin e ekspertit shqyrtues dhe duke i analizuar të gjitha ato në kontekstin e përgjithshëm të kësaj çështje ka krijuar bindjen e pavarur e tij/sajë, se ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar. Në ketë rast Paneli shpjegon se raporti i ekspertizës është hartuar në mënyrë profesionale dhe i njëjti i përmban të gjitha pohimet ankimore dhe analizat lidhur me to, duke i shpjeguar në mënyrë specifike në raport me dispozitat e shkelura, sikurse kërkohet kjo së paku me dispozitën e nenit 113 dhe 114 të LPP-së. Si rrjedhojë, Paneli Shqyrtues e mbështet rekomandimin e ekspertit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënje të kontratës dhe rekomandon që lënda LOT 2 të kthehet në rivlerësim, vlene te ceket si pjeserisht e bazuar per shkak se edhe tek FDT-ja edhe lista e cmimeve eshte verejtur nje gabim aritmetik, mirëpo vleresohet se i njëjti nuk e ka tejkaluar pragun prej 2 % sikurse parashihet me RrPP, po ashtu verehet se edhe ne zbatim të dispozites ligjore te nenit 6 te LPP-se OE ankues ka ofruar me cmimin me te lire per LOT 2

OE ankues në rivlerësim është shpallë i pasuksesshëm.

I njëjti pas refuzimit të kërksës për rishqyrtim parashtron ankesë pranë OSHP-së duke pretenduar se AK gjatë rivlerësimit të aktivitetit të prokurimit ka shkelë Rregulloren për Prokurim Publik përkatësisht nenet: 40 paragrafi 9, 40 paragrafi 10, 41 paragrafi 3 dhe neni 44 paragrafi 3.

*(**Sqarim**:Të gjitha pretendimet e ankesës janë të përshkruara lartë në raport, tek pjesa Dispozitat e Shkelura dhe Pretendimet Ankimore)*

Pretendimi i parë OE ankues:

OE ankues pretendon se AK është dashur që ofertën e OE të rekomanduar ta shpallë të papërgjegjshme sepse sipa rregullores për prokurim publik neni 40 paragarfi 10 pika b. I njëjti duhet të eliminohet sepse pas korrigjimit ka ndryshim në vlerën e paramasës dhe në formular të tenderit.

<u>Përgjigje në pretendimin ankimor të OE ankues</u>

Ekspertja shqyrtuese, pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës, sqaron se pretendimi i Operatorit Ekonomik ankues lidhur me paramasën ku është përmirësuar vlera totale si gabim aritmetik **është i pabazuar**. Kjo llogaritje në këtë formë është konstatuar dhe konfirmuar edhe me Vendimin e Panelit Shqyrtues nr. 486/2026 të datës 14.09.2026.

Gjithashtu, sa i përket dispozitës së përmendur nga OE ankues, specifikisht nenit 40, paragrafi 10, pika (b) të Rregullores për Prokurimin Publik nr. 001/2022, **ekspertja shqyrtuese sqaron se** kjo pikë zbatohet ekskluzivisht gjatë fazës së ofertimit fillestar, në rastet kur ka mospërputhje ndërmjet vlerës në përshkrimin e çmimeve dhe vlerës së deklaruar në Formularin e Tenderit. Rrjedhimisht, ky **pretendim ankimor i OE ankues vlerësohet si i pabazuar.**

Citat RRPP nr. 001/2022:

Neni 40.9 *Komisioni vlerësues do të përmirësojë gabimet plotësisht aritmetike në tender nëse gabimet e tilla zbulohen gjatë ekzaminimit të tenderëve, sidoqoftë ky përmirësim nuk mund të jetë më shumë se dy përqind (2%) i vlerës totale të ofertës.*

a. Ne rast se shuma e korrigjuar është me pak se +/- 2%, AK do të përmirësoj gabimet e tilla dhe do të informoj me shkrim OE në fjale duke përdorur formën standarde B49. në rast se OE në fjale nuk pranon përmirësimin e gabimit, oferta në fjalë do të refuzohet. AK gjithashtu duhet t'i dërgojë të gjithë tenderuesve përkatës (OE të cilët kanë dorëzuar tender) një njoftim me shkrim mbi ndryshimet e tilla.

b. Ne rast se shuma e korrigjuar është me shume se +/- 2%, AK do të eliminoj OE dhe do të informoj me shkrim OE në fjalë duke përdorur formën standarde B42.

Neni 40.10 *Tenderuesi do të informohet me shkrim menjëherë për korrigjime të tilla. Gabimet në llogaritjen e çmimit do të korrigjohen nga AK në këtë mënyrë:*

a. Në rast se ka mospërputhje ndërmjet çmimit njësi dhe çmimit total që është fituar duke shumëzuar çmimin për njësi dhe sasisë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total do të korrigjohet;

b. Në rast se ka mospërputhje mes çmimit total në Formularin e Tenderit dhe totalit në

Përshkrim të çmimeve, oferta refuzohet*.*

Neni 40.11 *Shumat e korrigjuara në këtë mënyrë janë të detyrueshme për tenderuesin:*

a. Në rast se tenderuesi nuk i pranon ato, tenderi i tij do të refuzohet;

b. ***Në asnjë rast çmimi për njësi nuk mund të korrigjohet****. Në rast se tenderuesi pretendon se ka bërë një gabim në çmimin për njësi, tenderi i tij do të refuzohet dhe konsiderohet si i tërhequr.*

Pretendimi i dytë i OE ankues

OE ankues pretendon se AK nuk ka publikuar formularin B49 prandaj është shkelë neni 40.9 i rregullores për prokurim publik.

<u>Përgjigje në pretendimin ankimor të OE ankues</u>

Lidhur me pretendimin e dytë ankimor, ekspertja shqyrtuese sqaron se në rastin konkret kemi të bëjmë me ofertim të dy zërave me vlerë të njëjtë, ku gjatë kalkulimit të shumës ka rezultuar një gabim aritmetik në shkallën nën 2%. Mbështetur në nenin 40, paragrafi 9, pika (a) të Rregullores për Prokurimin Publik, Autoriteti Kontraktues (AK) ka pasur obligim që të përmirësojë këtë gabim dhe të kërkojë pëlqimin e ofertuesit për totalin e korrigjuar.

Mirëpo në këtë situatë, ka qenë vetë Operatori Ekonomik ankues ai që ka kërkuar korrigjimin e totalit dhe trajtimin e tij si gabim aritmetik. Duke qenë se ky përmirësim ka rezultuar nën

vlerën prej 2%, ai është trajtuar si i tillë, pa u aplikuar Formulari B49, me qëllim të respektimit të plotë të Vendimit të Panelit Shqyrtues. Rrjedhimisht, ky **pretendim ankimor i OE ankues vlerësohet si pjesërisht i bazuar.**

Pretendimi i tretë i OE ankues

OE ankues pretedon se Korrigjimi nuk është bërë nga Kosmioni i rivlerësimit sipas nenit 40.9 të RRPP-së, mirëpo vetëm kanë publikuar rivlerësimin duke u thirr në Vendimin e OSHP-së.

Përgjigje në pretendimin ankimor të OE ankues

Lidhur me pretendimin e tretë ankimor, ekspertja shqyrtuese sqaron se në raportin e rivlerësimit është potencuar domosdoshmëria e respektimit të Vendimit të OSHP-së. Në përputhje me nenin 131 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP), Autoriteti Kontraktues (AK) ka obligim ligjor të zbatojë afatet e përcaktuara në vendim. Rrjedhimisht, ky pretendim i Operatorit Ekonomik ankues vlerësohet si **i pabazuar**.

Tutje, sa i përket pretendimit të OE ankues lidhur me shtrembërimin e konkurrencës përmes manipulimit të çmimeve të tregut nga ana e disa ofertuesve, ekspertja shqyrtuese sqaron se shqyrtimi dhe hetimi i këtyre pretendimeve nuk hyn në fushëveprimin e mandatit të saj ligjor. Rrjedhimisht, rekomandohet që palët, nëse posedojnë dëshmi dhe fakte relevante, ti adresojnë ato pranë autoriteteve kompetente për mbrojtjen e konkurrencës.

Pretendimi i katërt i OE ankues

OE ankues në pretendimin e katërt shpejgon duke ofruar disa fatura dhe llogaritje lidhur me çmimin e ofruar me pretendimin se OE i rekomanduar për LOT 2 ka ofruar çmim abnormalisht të ulët dhe se duhet trajtuar si të tillë.

Përgjigje në pretendimin ankimor të OE ankues

Ekspertja shqyrtuese pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës sqaron se, në paramasën e OE të rekomanduar çmimi njësi është ofruar për 4 pozicione në vlera të ndryshme, varësisht kërkesës, sasisë, madhësisë etj.

Rrjedhimisht konform nenit 4 të Rregullores për Prokurim Publik nr.001/2022 paragrafi 1 pika (c), është në përgjegjësi të AK-së që gjatë administrimit të procedurës së prokurimit të sigurohet edhe që çmimi i kontraktuar të mos jetë më i lartë se çmimi i tregut.

Citat neni 4 RRPP:

NENI 4 - Administrimi i përgjithshëm i procedurave të prokurimit

4.1 Gjatë administrimit të procedurave të prokurimit, Autoriteti Kontraktues do të ketë obligimet në vijim:

a. të luaj rolin aktiv në përcaktimin e kushteve të kontratave, me theks të veçantë për çmimet,

afatet e dorëzimit, sasitë, karakteristikat teknike dhe garancive;

b. për aq sa është e mundshme në bazë të rrethanave, të bëhet krahasimi efektiv i kërkesave për pjesëmarrje dhe tenderëve për të përcaktuar avantazhet e tyre relative dhe disavantazhet; dhe

c. të sigurohet që çmimi i kontraktuar nuk është më i lartë se çmimi i tregut.

Dhe si e tillë, sipas kalkulimit të ofertave totale konform nenit 41 paragrafi 3 i RRPP-së, e njejta nuk kalon vlerën 30 % të ofertës më të ulët, pozicionet sipas paramasës në DT kanë sasinë e përafërt të caktuar me devijim +/- 30%, dhe si e tillë, përkundër faktit se Operatori Ekonomik ankues ka bashkëngjitur disa fatura dhe kalkulime në kërkesën për rishqyrtim dhe në ankesë me qëllim që të dëshmojë se pozicioni i ofruar përmban çmim jonormalisht të ulët, Autoriteti Kontraktues ka sqaruar në përgjigjen e tij se dallimi ndërmjet ofertës së OE-së të rekomanduar për kontratë dhe ofertës së OE-së ankues është vetëm 1%, mbi këtë bazë,atëherë duke qenë se AK posedon diskrecionin për hulumtim dhe analizim të tregut, ku e njejta nuk ka konsideruar konform nenit 41. 4 të RRPP-së se çmimi i ofruar në pozicionin katër është jonormalisht i ulët, atëherë mbetet në diskrecion të AK-së, **andaj pretendimi i OE ankues nuk gjendet i qëndrueshëm,** për faktin se, meqë sasia egziston, OE nuk mund të anashkaloj pozicionin pa furnizuar ose të ndryshoj të njejtën.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **Agjencia Qendrore e Prokruimit**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **OFFICE 1 KOSOVA SH.P.K.**

Blerina Huruglica